

# HAP PAS HAPI

## Trajnimi për klasën e dytë

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij programi pjesëmarrësit përfitojnë:

- Njohjen e *koncepteve të përgjithshme filozofike dhe bazën teorike të programit me në qendër fëmijën*
- Njohjen e *praktikave të përshtatshme zhvillimore që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi si qenie intelektuale, sociale dhe emocionale*
- Aftësi për organizimin e *mësimit të individualizuar*, që nënkupton respektimin e potencialit zhvillimor të secilit individ në aspektin psiko-social, fizik, shoqëror, gjinor
- Aftësi për krijimin e mundësive për liri të shprehjes, të drejtën për zgjedhje dhe vendosjen për përgjegjësi që reflektojnë *frymën demokratike në klasë*
- Aftësi për *organizimin e mësimit kooperativ* që nxit bashkëveprim të hapur dhe të përgjegjshëm
- Aftësi për *planifikimin e mësimit të integruar dhe mësimit tematik* me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies
- Shkathtësi për *vëzhgimin e fëmijës gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimin e efekteve të punës në klasë*
- Aftësi për *aplikimin e teknikave të përshtatshme të mësimdhënies në procesin e përvetësimit të njohurive nga përmbajtjet e ndryshme programore*
- Ide për krijimin e një *ambienti stimulus për mësimnxënie aktive*
- Njohuri për *përfshirjen e familjes në realizimin e programit*

## Përmbajtja e trajnimit

Individualizimi I, individualizimi II, stilet e mësimnxënies, inteligjencat e shumëfishta, integrimi, mësimi tematik, të mësuarit përmes lojës, puna në ekip, mjedisi fizik dhe emocional i klasës, lexim – shkrimi, matematikë – shkenca, edukatë shoqërore.

## Grupi i synuar

Ky program u dedikohet mësuesve të shkollave fillore, të punësuarve në administratë arsimore, zyrtarëve të arsimit, pedagogëve, profesorëve dhe studentëve të Universitetit, si dhe trajnerëve të programit.

## Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Trajnimet për shkollë fillore realizohen në kontinuitet për katër vitet akademike në ciklin e ulët të shkollës fillore. Trajnimet mbështesin objektivat e njehta të programit HpH, porse veçojnë karakteristikat e moshës së fëmijëve, si dhe veçantitë e programit të shkollës për nivele të ndryshme. Ato thellojnë njohuritë për problemet e trajtuara në fjalë si dhe zgjerojnë njohuritë për teknika dhe forma të reja të mësimdhënies gjatë procesit mësimor.

Trajnimi për klasën e dytë realizohet brenda tri ditëve me gjithsejt 24 orë trajnim dhe pasohet me 4 punëtori njëditore gjatë një viti.

Me qëllim që të përcillet puna në kontinuitet dhe të punohet sa më shumë në cilësi të punës, çdo muaj parashihen monitorime në klasë.

## Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja 90% në trajnim.